



Nr. prot: 01-1206//24

Më: 05/07/2024

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, Ligjin për Arsim dhe Aftësim Profesional Nr. 04/L-138, dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës Nxënës, si dhe vendimit të Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me Nr. 01/440, datë 21.07.2023, Shkolla e Mesme e Mjekësisë "KEKA-MED", shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të në Institucioni i Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) "KEKA-MED" në Klinë

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në IAAP në vitin shkollorë 2024/2025, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në IAAP, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulet (6-9)
- Ekstraktin e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në IAAP për vitin shkollor 2024/25, bëhet në dt. 09,10 dhe 11 Korrik 2024, në objektin e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "KEKA-MED" në Klinë, duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në objektin e shkollës më datën: 12.07.2024.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës: 15.07.2024.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesat parashtrihen në drejtorinë e shkollës.

Kriteret për Regjistrim

Nxënësi për regjistrim për klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1	Suksesi nga shkollimi i obliguar	40 %	40 pikë
2	Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar	20%	20 pikë
3	Numri i pikëve nga testi	40%	40 Pikë

Nxënësi maksimalisht duhet t'i fitojë (100%) 100 pikë.



SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË
"KEKA - MED"
KLINË

Adresa: Rr. "Sadik Rama", p.n. - Klinë, 32.000 / Email: shmpkekamed@gmail.com / Kontakt: +383(0) 44/48 663001

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për Shkollën e Mesme të Mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga këto lëndë (se pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat 6-9, pastaj mesatarja e mesatarëve të atyre lëndëve).

Nxënësi nga sukseksi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$- \text{Sukseksi (kl. 6+kl.7+kl.8+kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga sukseksi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.
Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = pikë max.

- **Lëndët me prioritet më sukses sipas profileve në IAAP**
Shëndetësi: Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Kriteri i suksesit (notat) në lëndët prioritare për drejtimin shëndetësi:

IAAP – mesatarja e lëndëve: Fizike, Kimi, Biologji dhe Gjuhë shqipe dhe Letërsi, së paku duhet të jetë katër (4), si dhe 40% të pikëve të lëndëve prioritare në test (10 pikë nga lëndët: Fizik, Kimi, Biologji dhe Gjuhë shqipe dhe Letërsi).

$$\text{Mesatarja (Kimi)} + \text{mesatarja (Biologji)} + \text{mesatarja (Fizik)} + \text{mesatarja (Gjuhë shqipe dhe Letërsi)} = 4$$

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Shkollën e Mesme të Mjekësisë "KEKA-MED" në Klinë, viti shkollor 2024-2025

Planifikimi						
Viti shkollor 2023-2024						
Nr	Shkolla	Drejtimi	Profili	Paralele	Nxënës	Gjithsej
1.	SHMM "KEKA-MED"	Mjekësi	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	2	30	60
2.	SHMM "KEKA-MED"		Teknik i Farmacisë	1	28	28
3.	SHMM "KEKA-MED"		Asistent Dentar	1	25-30	30
Totali:				4	88	118



Drejtori i shkollës:
Msc: Ilir Keka